

V E N D I M
Nr.520, datë 21.9.2000

PËR DHËNIE FONDI PËR PARTI TË REJA POLITIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. T’u japë partive politike: “Forca Albania”, “Lëvizja punëtore shqiptare” dhe “Socialkristiane shqiptare”, nga një fond ndihme prej 100 000 (njëqind mijë) lekë secilës.
 2. Fondi prej 300 000 (treqind mijë) lekë të përballohet nga fondi rezervë për partitë e reja.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta